



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



„Radio Alba“
Pronar: Lekë MUSOLLI
OSHP TV ALBA
OSHP19
Rr/Ulpiana-D/3H/6 Nr. 1
Prishtinë

Ref: 1404/531/KPM/ni

VENDIM

për shpalljen e pavlefshme të licencës së OSHP TV ALBA

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHP TV ALBA është një ofruer i shërbimeve programore i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për të ofruar programe përmes rrjetit kabllor, në pajtim me rregulloren CIMC 2007/04. OSHP TV ALBA është pajisur me licencë të KPM-së më 17 mars 2009
3. OSHP TV ALBA edhe pse është licencuar nga KPM, për të vepruar si Ofruer i Shërbimeve Programore me seli në Prishtinë, asnjëherë nuk ka filluar me transmetim të programit.
4. Më 30 dhjetor 2013, KPM është njoftuar zyrtarisht me shkrim nga OSHP TV ALBA, se heq dorë nga licenca për ofrimin e shërbimeve programore.
5. Përmes të njëjtës shkresë, OSHP TV ALBA, ka njoftuar se, për shkaqe financiare heqë dorë nga licenca e KPM-së.

Arsyetimi

6. Me njoftimin e OSHP TV ALBA që në mënyrë vullnetare heqë dorë nga licenca e ofruesit të shërbimeve programore, Komisioni, lëshon Vendim për shpallje të pavlefshme të licencës të OSHP TV ALBA.

Vendim

7. Komisioni merr këtë Vendim përmes të cilit shpallë të pavlefshme Licencën e OSHP TV ALBA për ofrimin e shërbimeve programore, që nga data e njoftimit të përfaqësuesit të OSHP TV ALBA.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë Vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



15.05.2014
datë